

RRJEDHA E PUNËS PËR APLIKIMIN PËR PENSION NË ALSSH DHE NË ZYRAT E ADISA-s



ALSSH dhe ADISA tashmë janë zyra informacioni, si dhe zyra që asistojnë qytetarët që aplikojnë për të përfituar një pension apo të ardhura të tjera, sipas dispozitave të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar dhe sipas dispozitave për programe të veçanta shtetërore apo sigurime suplementare, të zbatuara nga ISSH dhe strukturat rajonale, njëkohësisht duke marrë, inventarizuar dhe dërguar për plotësim dhe përpunim në zyrën rajonale edhe dokumentat që dorëzohen nga qytetari aplikant.

Qytetarët mund të marrin informacion më të hollësishëm, lidhur me dokumentacionin për pensionet si dhe procedurat për të siguruar këtë informacion drejtpërdrejt në ALSSH, në zyrat ADISA dhe në çdo rubrikë të aplikimit në portalin e-albania.al/ dhe në faqen zyrtare të ISSH-së www.issh.gov.al.

Bashkimi i aplikimit online të qytetarit me dokumentat e marra në format elektronik, si dhe krijimi i plotë i dosjes së pensionit në letër dhe në format elektronik do të bëhet në zyrat e Degës së përfitimeve të DRSSH-ve, të cilat tashmë do të marrin funksionet e:

- plotësimi të dokumentacionit të dosjes së pensionit, duke komunikuar brenda DRSSH-ve, me DRSSH-të si motra dhe me institucionet e tjera, duke verifikuar on-line dokumentacionin e dërguar nga vetë qytetari;
- komunikimit me qytetarin për çdo problematikë, marrjen on-line ose me postë të çdo dokumenti shtesë, të nevojshëm, për saktësimin apo plotësimin e periudhave të sigurimit, etj;
- komunikimit me qytetarin për pensionin e caktuar, llogaritjet e masës së pensionit dhe postimin për pagesë në Zyrat Postare ose në Banka, sipas kërkesës së tij.

Në këtë proces, për të gjithë specialistët e ALSSH-ve asistenca ndaj qytetarit për aplikim, thjeshtimi i procedurave, marrja prej tij e sa më pak dokumentave të domosdoshme, zbatimi i rregullave të etikës profesionale dhe kulturës njerëzore, është një detyrim.

Informatizimi i sistemit të aplikimeve për shërbime apo për njohjen dhe marrjen e të drejtave në fushën e sigurimeve, ka si qëllim:

- Rritjen e standarteve të shërbimeve dhe të plotësimi të kërkesave;
- Eliminimin e rradhëve, vonesave, ngatërresave, dokumentave të tepërta, ndërhyrjeve etj;
- Përgjegjshmërinë e strukturave shtetërore për të plotësuar vetë dhe midis tyre të gjithë dokumentacionin administrativ të kërkuar nga dispozitat ligjore, pa cënuar standartet e administrimit financiar të fondeve publike;
- Shmangien e fenomeneve që çenojnë rregullat e etikës dhe të shërbimit midis punonjësit të administratës dhe kërkuesit;
- Krijimin e mundësive teknike për monitorimin e çdo shërbimi për standartet dhe kohën e plotësimi të tij.